


## Udhëzues për marrjen dhe hetimin e shkeljeve të rregullave<sup>1</sup> në Messer



Kërkesat e mëposhtme shërbejnë si udhëzues për marrjen dhe hetimin e raporteve nga personat përgjegjës të përcaktuar në këtë udhëzim dhe duke pasur parasysh të drejtat e personave të përmendur. Ato duhen kuptuar në kontekstin e udhëzuesit për raportimin dhe trajtimin e shkeljeve të rregullave në Messer.

Nëse standardet e përcaktuara në këtë udhëzues janë të ndryshme nga ato që kërkohen nga ligji ndërkombëtar ose vendor në fuqi, do të zbatohet standardi më i rreptë nëse nuk kundërshtohet me ligjin ndërkombëtar ose vendor në fuqi. Kjo do të thotë që edhe në rastet kur ligji ndërkombëtar ose vendor i zbatueshëm është më pak i rreptë, punonjësit duhet t'i përmbahen këtij udhëzimi në masën e lejuar ligjërisht.

### 1 Marrja e raporteve

- 1.1 Duhet të sigurohet që të gjitha raportet e shkeljeve të rregullave, pavarësisht nga departamenti ose zona nga vijnë, t'i përcillen një Menaxheri për Pajtueshmërinë<sup>2</sup>, në rast dyshimi, raportet duhet t'i përcillen Përgjegjësit të Lartë për Pajtueshmërinë.
- 1.2 Përgjegjësi i Lartë për Pajtueshmërinë dhe Menaxheri i Korporatës për Pajtueshmërinë janë personat e vetëm të autorizuar që kanë akses në postën elektronike për pajtueshmërinë (compliance@messergroup.com) dhe Linjën e Integritetit.
- 1.3 Besueshmëria e raporteve të marra nëpërmjet linjës telefonike të pajtueshmërisë ose Linjës së Integritetit shqyrtohet fillimisht nga Përgjegjësi i Lartë për Pajtueshmërinë. Ai ose ajo vendos nëse një raport i caktohet një Menaxheri të Pajtueshmërisë sipas Fushës së shkeljes së raportuar ose një Menaxheri Vendor për Pajtueshmërinë për përpunim të mëtejshëm.

---

<sup>1</sup> Termat e përdorur në këtë udhëzim janë identike me ato në *Udhëzuesin për raportimin dhe trajtimin e shkeljeve të rregullave në Messer*.

<sup>2</sup> Përgjegjësitë e Menaxherëve për Përpunueshmërinë përcaktohen në *Udhëzuesin e Përgjegjësit për Pajtueshmërinë* (i disponueshëm në intranetin e pajtueshmërisë dhe në faqen e internetit të Messer).

## 2 Mbrojtja e konfidencialitetit<sup>3</sup>

Marrja e raporteve duhet të projektohet, organizohet dhe operohet për të siguruar që identiteti i Sinjalizuesit, personit të interesuar nga raporti dhe palëve të treta të përmendura në raport, të mbetet konfidencial dhe që punonjësit e paautorizuar të mos kenë akses në këtë informacion.

## 3 Verifikimi i besueshmërisë së raporteve, delegimi i gjurmimit të tyre<sup>4</sup>

- 3.1 Raportet mbi shkeljet e rregullave shqyrtohen fillimisht për besueshmëri. Nëse një raport nuk duket i besueshëm, Sinjalizuesit duhet t'i jepet një mundësi për të konkretizuar informacionin e tij/saj. Nëse nuk rezulton konkretizimi ose Sinjalizuesi nuk jep ndonjë informacion të mëtejshëm, mund të ndërpritet hetimi i mëtejshëm.
- 3.2 Nëse shkelja e raportuar e rregullit rezulton e besueshme, por nuk ka të bëjë me një mospërputhje serioze ose nuk është veçanërisht e dëmshme për Messer, Menaxheri përgjegjës për Pajtueshmëri, në konsultim me Përgjegjësën e Lartë për Pajtueshmërinë, mund të delegojë hetimin e kërkuar dhe ndjekjen e shkeljeve në departamentin përgjegjës për të. Pas përfundimit të hetimit të brendshëm, departamenti përgjegjës duhet të informojë me shkrim Menaxherin për Pajtueshmërinë për rezultatet dhe çdo sanksion që duhet të aplikohet.

## 4 Komunikimi me Sinjalizuesin

- 4.1 Brenda një periudhe prej shtatë ditësh kalendarike pas marrjes së raportit, Menaxheri përgjegjës për Pajtueshmërinë do t'i konfirmojë Sinjalizuesit marrjen e raportit.
- 4.2 Nëse shkelja e raportuar e rregullit rezulton e besueshme dhe Menaxheri përgjegjës për Pajtueshmërinë arrin në përfundimin se Sinjalizuesi mund të ketë informacione të mëtejshme mbi shkeljen e raportuar të rregullit, që mund të jenë të dobishme për vlerësimin e fakteve, ai / ajo duhet t'i kërkojë Sinjalizuesit të japi informacione të mëtejshme dhe të qëndroj në kontakt me të.
- 4.3 Jo më vonë se tre muaj pas konfirmimit të marrjes së raportit, Menaxheri përgjegjës për Pajtueshmërinë duhet të informojë Sinjalizuesin për çdo masë vijuese të marrë, rezultatin ose përfundimin e hetimit të brendshëm.
- 4.4 Nëse Sinjalizuesi kërkon një takim fizik, kjo kërkesë duhet të plotësohet brenda një afati të arsyeshëm kohor. I njëjti Menaxher për Pajtueshmërinë që ka qenë në kontakt me Sinjalizuesin më parë duhet të marrë pjesë në këtë takim.

## 5 Hetimi i raporteve

- 5.1 Hetimi i raporteve duhet të kryhet nga persona për të cilët mund të përjashtohet çdo konflikt interesi në lidhje me hetimin. Hetimi i brendshëm mund të kryhet edhe nga një nga personat e përcaktuar që ka marrë raportin.
- 5.2 Grupi i personave të përfshirë aktualisht në një hetim të brendshëm për shkak të rasteve të dyshuara të shkeljes së thjeshtë të rregullit, si dhe bashkëpunimi ndërmjet personave do të përcaktohet dhe

---

<sup>3</sup> Shihni përshkrimin e detajuar në nr. "7. Mbrojtja e Sinjalizuesve dhe mbështetësve" në *Udhëzuesin për raportimin dhe trajtimin e shkeljeve të rregullave në Messer*

<sup>4</sup> Shihni përshkrimin e detajuar në nr. "5. Procesi i raportimit" në *Udhëzuesin për raportimin dhe trajtimin e shkeljeve të rregullave në Messer*

dokumentohet ndërmjet Menaxherit Vendor për Pajtueshmërinë ose Menaxherit të Pajtueshmërisë sipas Fushës së shkeljes së raportuar dhe drejtuesve vendor.

- 5.3 Komiteti për Pajtueshmërinë këshillon dhe vendos për shkelje të rënda të rregullave. Komiteti për Pajtueshmërinë përbëhet nga personat e mëposhtëm: Anëtari i Bordit Drejtues të Menaxhmentit Messer për Europen Juglindore për fushën në të cilën ka ndodhur shkelja e mundshme e rregullave, Përgjegjësi i Lartë për Përputhshmërinë, Drejtuesit përgjegjës Rajonal, Drejtuesit vendor, përfaqësuesi i Burimeve Njerëzore të Korporatës dhe një përfaqësues i Auditimit të Brendshëm. Përgjegjësi i Lartë për Përputhshmërinë mund të marrë gjithashtu përsipër hetimet e shkeljeve të rregullave të thjeshta.
- 5.4 Në rast të shkeljes së rëndë të rregullave, Përgjegjësi i Lartë për Përputhshmërinë duhet të krijojë një plan hetimi dhe ta zbatojë atë në përputhje me rrethanat; ai gjithashtu mund t'ia delegojë këtë detyrë Përgjegjësit të Korporatës për Pajtueshmërinë, një Menaxheri të Pajtueshmërisë sipas Fushës së shkeljes së raportuar ose një Menaxheri Vendor për Pajtueshmërinë.
- 5.5 Hetimi i brendshëm duhet të përfundojë me një raport me shkrim duke përfshirë rekomandimet për procedura të mëtejshme. Këto procedura të mëtejshme mund të përfshijnë gjithashtu masa disiplinore, si dhe informacionin dhe përfshirjen e autoriteteve të zbatimit të ligjit ose autoriteteve të tjera mbikëqyrëse.
- 5.6 Nëse raporti rezulton se ka pasur një shkelje të thjeshtë të rregullave në kuptim të seksionit 1.1. të *Udhëzimit për raportimin dhe trajtimin e shkeljeve të rregullave në Messer*, duhet të informohen për rezultatin e hetimit drejtuesit vendor dhe drejtuesit rajonal.
- 5.7 Nëse raporti rezulton se shkelja e rregullave është serioze sipas kuptimit të seksionit 1.2 të *Udhëzimit për raportimin dhe trajtimin e shkeljeve të rregullave në Messer*, duhet të të informohen për rezultatin e hetimit drejtuesit rajonal dhe anëtari përgjegjës i Bordit Drejtues të Menaxhmentit Messer për Europën Juglindore.
- 5.8 Përgjegjësi i Lartë për Pajtueshmërinë do të përfshijë rezultatet e raporteve në përputhje me seksionin 5.5. më lart në raportimin e tij vjetor në Bordin Drejtues (listimi i të gjitha shkeljeve të raportuara) dhe Bordit Mbikëqyrës (raportimi i shkeljeve materiale) të Messer.

## 6 Mbrojtja e Sinjalizuesve

- 6.1 Sinjalizuesit dhe personat mbështetës duhet të mbrohen gjatë dhe pas hetimit të brendshëm nga çdo formë hakmarrjeje / ndëshkimi (p.sh. masat disiplinore, transferimi i detyrave, mohimi i përfitimeve, vlerësimet negative të performancës, diskriminimi, etj.) ose kërcënimet për hakmarrje dhe tentativa për hakmarrje.
- 6.2 Sinjalizuesit Anonimë marrin të njëjtën mbrojtje si Sinjalizuesit që tregojnë identitetin e tyre që në fillim. E njëjta gjë vlen edhe nëse Sinjalizuesit anonimë identifikohen gjatë një hetimi të brendshëm.
- 6.3 Sinjalizuesit nuk duhet të jenë në disavantazh nëse bëjnë raportin e tyre drejtpërdrejt autoriteteve të zbatimit të ligjit ose autoriteteve të tjera mbikëqyrëse. E njëjta gjë vlen edhe për raportimet ndaj palëve të tjera të treta nëse Sinjalizuesit kishin arsye të besonin se shkelja e rregullit mund të përbënte një rrezik të menjëhershëm ose të dukshëm për interesin publik, p.sh. në një situatë emergjente ose ku ekziston risku / rreziku i dëmit të pakthyesëm.

Mbrojtja e Sinjalizuesve jashtë BE-së, të cilët raportojnë drejtpërdrejt te palët të treta (në kuptimin e fjalive 1 dhe 2) do të bazohet në rregulloret specifike të vendit.

## **7 Mbrojtja e personave të interesuar**

- 7.1 Personat e prekur nga një raport prezumohen të jenë të pafajshëm derisa të provohet e kundërta.
- 7.2 Personave të interesuar nga një raport duhet t'u jepet mundësia për të komentuar në lidhje me faktet e dyshimta. Ata kanë të drejtë të aksesojnë dosjen. Personat e përfshirë nga një raport nuk mund të kenë pretendime për të zbuluar identitetin e Sinjalizuesit.
- 7.3 Sinjalizuesit që bëjnë një raport me qëllim të keq ose në mënyrë të pahijshme duhet të presin pasoja ligjore, duke përfshirë veçanërisht masat sipas legjislacionit të punës.

## **8 Dokumentimi**

- 8.1 Marrja, përpunimi, përcjellja, hetimi i raporteve dhe përfundimi i masave hetimore duhet të dokumentohen me shkrim.
- 8.2 Dokumentimi dhe ruajtja e tij do të kryhet në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

## **9 Sjellje e pahijshme**

Dispozitat e mësipërme zbatohen edhe për hetimin e sjelljes së pahijshme.

\*\*\*

Bad Soden, 03.08.2023

Messer SE & Co. KGaA

Bernd Eulitz  
CEO

Helmut Kaschenz  
CFO

Virginia Esly  
COO për Europën